

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Ibadete Zullufi, në lëndën penale kundër të pandehurve H.H. dhe H.M. për veprën penale në bashkëkryerje Keqpërdorimi i Pozitës Apo Autoritetit Zyrtarë nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të pandehurit V.F. dhe A.R. për veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve në bashkëkryerje nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, po ashtu të pandehurin V.F. për veprat penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale Deklarimi i Rremë Nën Betim nga neni 391 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.13/12014 të datës 04.12.2014, pas veçimit të lëndës sipas aktvendimit PKR.nr.131/16 të datës 03.03.2016, dhe mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 03.03.2016 në të cilën morën pjesë Prokurori nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Admir Shala, i pandehuri V.F. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.B.J. , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri **V.F.** , nga i ati I. dhe nëna E. e gjinisë Z., i lindur me datë **data e lindjes...** në I., ku edhe tani jeton, rr.”S.” (R. e R.) pn. me profesion ndërtimtarë, pronarë i kompanisë “C. G” sh.p.k P., ka të kryer fakultetin e telekomunikacionit dhe logjistikës, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, I pa dënuar më parë, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

- 1) Në periudhën kohore 01.03.2013 deri 21.06.2013, në P., i pandehuri V.F në cilësinë e personit përgjegjës dhe pronarit të biznesit “C.G”, ndërsa A.R , në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të kontabilitetit përmes biznesit “E. – S.” për biznesin “C.G”, me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për biznesin “C.G ” në bashkëkryerje dhe me dashje përpilojnë dhe përdorin dokumentet e falsifikuar, dhe atë raportet e kontributeve për punëtorët e biznesit “C.G ” për periudhat tremujore TM-4 2010, dhe TM -4 2011, ku në periudhën TM-4 2010 kishte paraqitur 31 punëtorë, ndërsa për periudhën TM -4 2011 kishte paraqitur 33 punëtorë, kinse të paraqitur në ATK, e të cilat raporte janë përdorur në aktivitetin e prokurimit ”Ndërtimi i Lokaleve Afariste në Qytezën P.” me nr.të prokurimit NPB13/013/511, të iniciuara nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, ku si rezultat i përdorimit të këtyre dokumenteve kompania “C.G. ” është trajtuar si operatorë i përgjegjshëm dhe është shpallur fitues i kontratës me vlerë 1.779.759,54 euro, mirëpo nga shkresat dhe informatat e siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës është vërtetuar se këto raporte janë të falsifikuara, pasi që sipas regjistrave të ATK-së dhe Trustit Pensional figuron se për periudhën tremujore TM-4 2010, “C.G. ” ka raportuar në ATK se ka më së shumti 27 punëtorë, ndërsa për periudhën TM-4 2011 më së shumti 22 punëtorë, ndërsa kriter në dosjen e tenderit ka qenë që së paku t’i ketë 30 punëtorë të paraqitur në ATK për periudhat e lartcekura,-

Me këto veprime ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje nga neni 398 par.1 lidhur me par.31 të KPK-së.

2) Në periudhën kohore 01.03.2013 deri 21.06.2013, në P., në cilësinë e personit përgjegjës dhe pronarë në biznesin “C.G. ”, me qëllim të përfitimit të pasurisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit, e anë të paraqitjes së rreme të fakteve si dhe duke fshehur faktet, me dashje përpilon dokumente të falsifikuara, dhe dokumentet e falsifikuara i përdorë dhe i paraqet në dosjen e tenderit në aktivitetin e prokurimit të shpallur nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, me titull ”Ndërtimi i Lokaleve Afariste në Qytezën P.”, përkatësisht raportet e kontributeve për punëtorë për periudhat tremujore TM-4 2010, dhe TM-4 2011, gjë që me këto veprime e ka mashtruar menaxherin e prokurimit dhe komisionin vlerësues të Zyrës së Prokurimit të Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë gjatë vlerësimit të dosjes së tenderit ku ishte shpallur fitues operatori ekonomik “C.G. ” me çmim prej 1.779.759,54 euro, dhe me këtë e ka nxitur autoritetin kontraktues – Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, që të kryej një veprim në dëm të pasurisë së autoritetin kontraktues – Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, dhe operatorëve të tjerë ekonomik të renditur sipas vlerësimit të raportit të komisionit vlerësues të tenderit, pasi që ka ekzistuar baza juridike që fitimi nga operatorët e tjerë të realizohet,-

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

3) Me datën 24.04.2013 në P., i pandehuri V.F. në cilësinë e personit përgjegjës dhe pronarit të biznesit “C.G. ” gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit në aktivitetin e prokurimit të shpallur nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, me titull ”Ndërtimi i Lokaleve Afariste në Qytezën P.”, nënshkruan deklaratën nën betim , si pjesë e dokumenteve të dosjes së tenderit, përmes të cilave pranon mundësin e shqiptimit të sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse për shkak të pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarate që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese, ku në të vërtetë është vërtetuar se i njëjti ka dorëzuar dokumentet mashtruese në dosjen e tenderit, përkatësisht raportet e kontributeve për punëtorë për periudhat TM-4/2010 dhe TM-4/2011 të biznesit “C.G. ”, të cilat janë në fakt me përmbajtje të rreme dhe mashtruese,-

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Deklarimi i Rremë Nën Betim nga neni 391 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenet e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,45,46,47,73,80 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, e gjykon:

I. Të pandehurit **V.F.** I caktohen dënimet si në vijim: për veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve në Bashkëkryerje nga neni 398 par.1 lidhur me par.31 të KPK-së **DËNIM NË GJOBË** në shumë prej 500 € (pesëqind euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin kohorë prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- II. Për veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së i caktohet DËNIM NË GJOBË në shumën prej 15.000,00 € (pesëmbëdhjetëmijë euro) dhe DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (Gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 47 me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në DËNIM NË GJOBË në shumën prej 10.000,00 €, (dhjetëmijë euro), të cilat dënime i pandehuri është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Për veprën penale Deklarimi i Rremë Nën Betim nga neni 391 par.1 të KPRK-së i caktohet DËNIM NË GJOBË në shumë prej 500 € (pesëqind euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin kohorë prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 80 par.1 dhe 2 nënpar.2.4 Gjykata shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË NË SHUMË PREJ 26.000,00 (njëzetegjashtëmijë euro) të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin kohorë prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk paguan dënimet e shqiptuara në gjobë, gjykata do t'i zëvendësoj dënimet e shqiptuara me gjobë me dënim burgimi ku një ditë burgimi do t'i llogaritet për 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 100 €, në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë PPS.nr.13/2014 të datës 04.12.2014, me të cilën ka akuzuar të pandehurit H.H. dhe H.M. për veprën penale në bashkëkryerje Keqpërdorimi i Pozitës Apo Autoritetit Zrtarë nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të pandehurit V.F. dhe A.R. për veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve në bashkëkryerje nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, po ashtu të pandehurin V.F. për veprat penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale Deklarimi i Rremë Nën Betim nga neni 391 par.1 të KPRK-së.

Me datë 03.03.2016 Gjykata ka marrë aktvendimit PKR.nr.131/16 të datës 03.03.2016 për veçimin e procedurës ndaj të pandehurit V.F. , dhe atë për shkaqe të arsyeshme, pasi që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë arritur Marrëveshje për Pranimin e Fajësisë PPS.13/2014 të datës 10.03.2015 me Prokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ku më pas Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë qështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PPS.nr.13/2014 të datës 13/2014, dhe po ashtu palët në procedurë si Prokurori nga Prokuroria Speciale, i pandehuri V.F. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.B.J. , kanë deklaruar se ende qëndrojnë në tërësi pranë Marrëveshjes Për Pranimin e Fajësisë PPS.nr.13/2014 të datës 10.03.2015.

Meqenëse i pandehurit e ka arritur Marrëveshjes Për Pranimin e Fajësisë për veprat penale me të cilat është akuzuar, gjykata konstatoi se Marrëveshja është përpiluar konform

dispozitave ligjore të parapara me nenin 233 të KPPK-së, po ashtu gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 233 par. 18 të KPPK-së sepse i pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, nuk ekzistojnë rrethanat e parapara në nenin 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së, andaj gjykata mori aktvendim me të cilin e ka pranuar Marrëveshjes Për Pranimin e Fajësisë për të pandehurin.

Konform nenit 233 par.21 gjykata në vazhdimin e seancës u ka dhënë mundësinë palëve që të japin deklaratat e tyre lidhur me dënimin, ku Prokurori i çështjes ka deklaruar se që mbetet pranë dënimit të rekomanduar sipas Marrëveshjes Për Pranimin e Fajësisë.

Mbrojtësi i ta pandehurit V.F. av.B.J. në deklaratën e tij lidhur me dënimin po ashtu ka theksuar se qëndron edhe më tutje pranë rekomandimeve si në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, dhe i ka propozuar gjykatës që dënimi i rekomanduar prej gjashtë muaj burgim konform nenit 47 të KPPK-së t'i zëvendësohet në dënim me gjobë, të cilin propozim e ka përkrahur edhe i pandehuri V.F. .

Lidhur me propozimin e mbrojtjes së të pandehurit për zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë, gjykata edhe një herë ka marrë mendimin e Prokurorit i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton një propozim të tillë, dhe ka shtuar se përfundimisht gjykata të vendosë lidhur me këtë propozim.

Gjykata vendosi që të pandehurit konform nenit 47 të KPPK-së, dënimin prej gjashtë muaj burg e paraparë sipas Marrëveshjes Për Pranimin e Fajësisë, dhe atë për veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPPK-së, me pëlqimin e të pandehurit t'ia zëvendësoj në dënim me gjobë, dhe më pas bazuar në dispozitat e nenit 80 par.1 dhe 2 nënpar.2.4 Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim unik si në pjesën dënuese të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 450 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.131/16, datë 03.03.2016

Sekretarja Juridike:
Ibadete Zullufi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.